



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA HIMARË
KRYETARI**

Nr. 2534 Prot.

Himarë, më 20.03. 2025

PROJEKTVENDIM

Nr. 13, datë 20.03.2025

PËR

**“MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PARKIMET PUBLIKE ME PAGESË NË
BASHKINË HIMARË”**

Bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 19.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, *i ndryshuar*, ligjin Nr.44/2025 “Kodi i procedurave administrative”, në ligjin Nr.93/2015 “Për turizmin”, ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 89/2022 “Për policinë bashkiake”, ligjin Nr. 10279/2010 “Për kundravajtjet administrative”, ligjin Nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, si dhe VKM-në nr. 408/2015 (i përditësuar me anë të VKM nr.377/2024) “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë:

VENDOSI:

1. Miratimin e “Rregullores për parkimet publike me pagese ne Bashkine Himare”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të gjithë aktet që bien ndesh me këtë rregullore, shfuqizohen.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata dhe Kryetari i Bashkisë Himarë.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike, bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 55 pika 6.

KRYETARI

Vagjel Tavo

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZËVENDESKRYETARI

Pervin
Gjiguria

Digitally signed by
Pervin Gjiguria
Date: 2025.03.19
20:00:16 +02'00'

Pervin Gjiguria

Grupi I punes

A .Munametaj

L. Mezani

Sokrat Kreku

Klodi Ajazaj

Laert
Mezani

Digitally signed by
Laert Mezani
Date: 2025.03.19
19:13:37 +02'00'

Klodi
Ajazaj

Digitally signed by
Klodi Ajazaj
Date: 2025.03.20
09:57:04 +02'00'



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË
KRYETARI

Nr. 2534 prot.

Himarë, më 20.03.2025

RREGULLORE PËR PARKIMET PUBLIKE ME PAGESË NË BASHKINË HIMARË

Pervin
Gjikutria

Digitally signed by
Pervin Gjikutria
Date: 2025.03.19
20:00:16 +02'00'

Laert
Mezani

Digitally signed by
Laert Mezani
Date: 2025.03.19
19:13:37 +02'00'

Klodi
Ajazaj

Digitally signed by
Klodi Ajazaj
Date: 2025.03.20
09:57:04 +02'00'

Përmbajtja

1. Dispozita të Përgjithshme
 - 1.1 Qëllimi i Rregullores
 - 1.2 Objekti i Rregullores
 - 1.3 Fusha e Zbatimit
 - 1.4 Përcaktime dhe Përkufizime
2. Zonat e Parkimit me Pagesë
 - 2.1 Identifikimi dhe klasifikimi i zonave
 - 2.2 Kufizimet dhe përfitimet për secilën zonë
3. Tarifat dhe Orari i Pagesës
 - 3.1 Tarifat për kategoritë e ndryshme të automjeteve
 - 3.2 Orari i aplikimit të pagesës
 - 3.3 Përjashtimet dhe lehtësimet nga pagesa
4. Procedurat e Pagesës
 - 4.1 Metodat e Pagesës
 - 4.2 Pajisjet për pagesa elektronike dhe alternativa të tjera
 - 4.3 Menaxhimi i pagesave dhe monitorimi
5. Rregullat e Përdorimit të Parkimeve
 - 5.1 Rregullat e përgjithshme për përdoruesit e parkimeve
 - 5.2 Ndalesa dhe kufizime specifike për përdorimin e hapësirave të parkimit
 - 5.3 Kushtet e përdorimit të hapësirave për automjetet elektrike dhe ato për ngarkim/shkarkim
6. Monitorimi dhe Kontrolli
 - 6.1 Metodat e monitorimit të parkimeve
 - 6.2 Kontrolli nga autoritetet bashkiake dhe sanksionet për shkelje
 - 6.3 Procedura e vendosjes dhe zbatimit të gjobave
7. Procedurat e Ankimit dhe Shqyrtimi i Shkeljeve
 - 7.1 Mekanizmi i ankesave për qytetarët
 - 7.2 Afatet dhe procedurat për shqyrtimin e ankesave
 - 7.3 Dispozitat për zbutjen ose anulimin e gjobave
8. Dispozita Kalimtare dhe Përfundimtare
 - 8.1 Afati i hyrjes në fuqi të rregullores
 - 8.2 Ndryshimet dhe përditësimi i rregullores
 - 8.3 Dispozita të tjera të zbatimit dhe përputhshmërisë me ligjin

Pervin
Gjukuria

Digitally signed by
Pervin Gjukuria
Date: 2025.03.19
20:00:16 +02'00'

Laert
Mezani

Digitally signed by
Laert Mezani
Date: 2025.03.19
19:13:37 +02'00'

Klodi
Ajazaj

Digitally signed by
Klodi Ajazaj
Date: 2025.03.20
09:57:04 +02'00'

1. Dispozita të Përgjithshme

Rregullorja për parkimet publike me pagesë në Bashkinë Himarë synon të rregullojë funksionimin, tarifat dhe përdorimin e hapësirave publike të parkimit, duke siguruar që këto shërbime të jenë në përputhje me standardet dhe nevojat e qytetarëve dhe vizitorëve.

Kjo rregullore përputhet me ligjet dhe aktet nënligjore të Republikës së Shqipërisë për qeverisjen vendore, menaxhimin e trafikut dhe administrimin e burimeve të bashkisë. Referencat specifike përfshijnë:

- **Ligje Kombëtare:**

- Ligji Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar
- Ligji Nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” me ndryshime
- Ligji Nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” me ndryshime
- LIGJ Nr. 89/2022 PËR POLICINË BASHKIAKE
- Ligji Nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundravajtjet administrative”
- Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar
- Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar
- Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, me ndryshime
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” me ndryshime
- Ligji Nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i ndryshuar
- Ligji Nr.9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i përditësuar
- Ligji Nr.9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i përditësuar.

- **Vendime të Këshillit të Ministrave (VKM):**

Pervin
Gjokuria

Digitally signed by
Pervin Gjokuria
Date: 2025.03.19
20:00:16 +02'00'

- Nr. 153, datë 07.04.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar
- Nr. 568, datë 06.10.2021 “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e

Laert
Mezani

Digitally signed by
Laert Mezani
Date: 2025.03.19
19:13:37 +02'00'

Klodi
Ajazaj

Digitally signed by
Klodi Ajazaj
Date: 2025.03.20
09:57:04 +02'00'

administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”

- Nr. 511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, me ndryshimet përkatëse
- Nr. 816, datë 16.11.2016 “Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetet publike”
- **Vendime të Këshillit Bashkiak (VKB) për:**
 - Strukturën e Policisë Bashkiake dhe kompetencat për vendosjen e gjobave vkb nr 04 datë 31.01.2020 “Për përcaktimin e disa kundravajtjeve administrative dhe sanksionet që vendosen në to në territorin e Bashkisë Himarë ”
 - VKB 39 datë 26.02.2016 “Miratimi i nivelit të gjobave dhe masat për kundravajtjet administrative”
 - Rregullorja e organizimit të Bashkisë Himarë së miratuar .
 - Paketën Fiskale të Bashkisë Himarë Nr 54 datë 25.11.2021 “Për paketën fiskale të vitit 2022” Bashkia Himarë, e ndryshuar

Qëllimi: Të vendosen rregulla të qarta për menaxhimin e parkimeve me pagesë, të zvogëlohet trafiku dhe të përmirësohet përvoja e qytetarëve në parkimin publik.

Fusha e Zbatimit: Rregullorja zbatohet për të gjitha hapësirat e parkimit që janë të caktuara nga Bashkia Himarë për përdorim publik dhe që janë nën sistemin e pagesës.

Objekti i rregullores: Rregullorja ka objekt disiplinimin/menaxhimin e hapësirave publike të parkimit, për lehtësimin e qarkullimit të mjeteve motorike në territorin e Bashkisë Himare.

2. Zonat e Parkimit me Pagesë

Parkimet publike me pagesë ndahen në zona specifike, të përcaktuara nga Bashkia Himarë, bazuar në densitetin e popullsisë, kërkesën për parkim dhe specifikat e trafikut. Çdo zonë mund të ketë tarifa dhe kushte të ndryshme përdorimi, në varësi të këtyre faktorëve.

Nr	Emertimi i rruges	Numri i parkimeve	Kahu
1	Jorgji Bollano	200	Ne nje kah te rruges
2	Vangjel Zoto (Kthes e Gume-Beleri)	250	Ne te dyja kahet rrugore
3	Vangjel Zoto (Beleri- Unaza)	140	Ne nje kah te rruges
4	Andre Dhima	60	Ne te dyja kahet rrugore
5	Xhoxhi Tened	40	Ne nje kah te rruges
6	Parkimi Qeparo	70	Parkim
7	Rruga e plazhit Borsh	400	Ne nje kah per sezon
8	Rruga e Plazhit Perivol	100	Ne nje kah per sezon

Pervin
Gjilkuria
Laert
Mezani

Ajazaj

--	--	--	--

3.1 Tarifat për Kategoritë e Ndryshme të Automjeteve

1. Automjetet e Lehta (Makinat Personale):
 - o Tarifa bazë për parkim përcaktohen për orë qëndrimi. Kjo tarifë mund të jetë e ndryshueshme bazuar në zonën e parkimit (p.sh., zonat me densitet më të lartë të kenë tarifë më të lartë).
 - o Tarifa ditore dhe opsioni i tarifës mujore për përdoruesit që parkohen rregullisht në zonat e parkimit publik.
2. Automjetet e Rënda (Furgona, Kamionë, Autobusa):
 - o Automjetet e rënda do të kenë një tarifë më të lartë për shkak të kërkesës për më shumë hapësirë dhe ndikimin më të madh që kanë mbi rrugët dhe infrastrukturën e parkimit.
 - o Këto automjete mund të parkohen vetëm në zona të caktuara dhe në përputhje me rregullat e vendosura për këtë kategori.
3. Automjetet Elektrike:
 - o Automjetet elektrike mund të përfitojnë nga tarifa të reduktuara për të inkurajuar përdorimin e mjeteve miqësore me mjedisin. Në disa raste, tarifa mund të jetë zero për një periudhë të caktuar kohe.
 - o Tarifa për përdorimin e stacioneve të karikimit do të përcaktohet bazuar në kohën e qëndrimit dhe energjinë e konsumuar gjatë karikimit.
4. Motoçikletat dhe Mjetet me Dy Rrota:
 - o Motoçikletat dhe biçikletat me motor mund të kenë një tarifë më të ulët në krahasim me automjetet e tjera, për shkak të hapësirës më të vogël që kërkojnë.
 - o Në disa zona të caktuara, këto mjete mund të kenë vende të dedikuara dhe tarifa të veçanta.
5. Automjetet për Personat me Aftësi të Kufizuara:
 - o Personat me aftësi të kufizuara mund të përfitojnë nga tarifa të reduktuara ose parkim falas në hapësirat e dedikuara. Përdoruesit e këtyre hapësirave duhet të kenë shenjë të posaçme të vendosur në automjet për identifikim.

1.f TARIFA E PARKIMIT TE AUTOMJETEVE NE SIPERFAQET PUBLIKE NE QYTET DHE SHESHE E RRUGE

Nr	Emertimi i llojit te automjeteve	Niveli i takses leke ne muaj	Parkim i rezervuar Pagesa vjetore ose me kontrate dhe me parapagim
	Transport pasagjeresh		
1	Automjete deri ne 5 vende	2000	20.000
2	Automjete 6-9 vende	2500	25.000
3	Automjete 10-25 vende	3500	35.000
4	Automjete 26-42 vende	4000	40.000

5	Automjete mbi 42 vende	4500	45.000
	Transport mallrash		
6	Automjete deri ne 2 ton	3000	30.000
7	Automjete 2-5 ton	4000	40.000
8	Automjete 5-10 ton	5000	50.000
9	Automjete 10-16 ton	6000	60.000
10	Automjete mbi 16 ton	7000	70.000
11	Parkimi orar me pagese per vetura ne sheshe, qendra..	50 leke/ora	
12	Parkimi orar me pagese per mikrobuza	70 leke/ora	
13	Parkimi orar me pagese per autobuza	100leke/ora	
14	Parkimi i organizuar nga Bashkia ne vende te caktuar	100 lek/ne 8 ore	300 lek/ne 24ore

3.2 Orari i Aplikimit të Pagesës

- Orari Ditor i Pagesës:
 - Parkimi me pagesë do të aplikohet gjatë ditës, në një orar të caktuar që mund të jetë nga ora 08:00 deri në 20:00, për të mbuluar periudhën e aktiviteteve kryesore të qytetit.
 - Gjatë natës, nga ora 20:00 deri në 08:00, parkimi është falas në disa zona të miratuara.
 - Përfshihen nga rregullimi orar zonat e ndjeshme, dhe parkimet e miratuara dhe ato me ngarkesë të lartë gjatë gjithë ditës.
- Orari për Ditët e Fundjavës dhe Festat Zyrtare:
 - Bashkia mund të vendosë një orar të ndryshëm për fundjavën (e shtuna dhe e diela) dhe ditët e festave zyrtare. Në disa raste, parkimi mund të jetë falas gjatë këtyre ditëve për të lehtësuar aksesin e vizitorëve.
 - Për zonat me aktivitete të lartë turistike, tarifat dhe orari i pagesës gjatë fundjavave dhe sezonit turistik mund të mbetet i njëjtë me ditët e zakonshme të javës.
- Sezonaliteti i Pagesës:
 - Duke qenë se Bashkia Himarë është një zonë turistike, orari dhe tarifat mund të ndryshojnë sipas sezonit (sezoni veror dhe ai dimëror) për të përmbushur kërkesën më të lartë gjatë sezonit turistik dhe për të lehtësuar aksesin për banorët gjatë sezonit të ulët.

3.3 Përfshirjet dhe Lehtësimet nga Pagesa

- Banorët Lokalë:**

Pervin Gjokuria

Digitally signed by Pervin Gjokuria
Date: 2025.03.19 20:00:16 +02'00'

Banorët e regjistruar në zonën përkatëse të parkimit mund të përfitojnë tarifa të reduktuara ose abonime mujore të veçanta. Kjo do t'u mundësojë atyre akses të përhershëm në hapësirat e parkimit në afërsi të banesave të tyre.

 - Për banorët që kanë automjete të regjistruara në emrin e tyre dhe që banojnë në zonat e parkimit me pagesë, mund të jepen leje për parkimi me tarifa të ulëta.

Laert Mezani

Digitally signed by Laert Mezani
Date: 2025.03.19 19:13:37 +02'00'

Klodi Ajazaj

Digitally signed by Klodi Ajazaj
Date: 2025.03.19 09:57:04 +02'00'

2. Personat me Aftësi të Kufizuara:
 - Personat me aftësi të kufizuara, me mjetet e tyre ose ato të familjarëve që i transportojnë, mund të përfitojnë nga parkimi falas në hapësirat e dedikuara. Përdoruesit duhet të pajisen me kartën e identifikimit të miratuar për këtë kategori.
3. Automjetet e Shërbimit Publik dhe Emergjencës:
 - Automjetet e policisë, zjarrfikësit, ambulancat, dhe automjetet e tjera të shërbimit emergjent janë të përjashtuara nga pagesa e tarifës së parkimit kur kryejnë detyrën e tyre të shërbimit.
 - Automjetet e shërbimeve publike të bashkisë dhe ato që kryejnë shërbime të domosdoshme të infrastrukturës kanë të drejtë të përdorin hapësirat e parkimit pa tarifë për periudhën e kryerjes së shërbimit.
4. Lehtësimet për Mjetet Elektrike:
 - Për të inkurajuar përdorimin e mjeteve elektrike, Bashkia mund të ofrojë lehtësime në tarifa ose periudha parkimi falas për mjetet elektrike, të cilat përdorin hapësirat me stacione karikimi.
 - Automjetet elektrike mund të përfitojnë tarifa më të ulëta gjatë gjithë orarit të parkimit ose të kenë lehtësime sezonale.
5. Vizitorët Afatshkurtër:
 - Për vizitorët që kanë nevojë për parkim afatshkurtër, mund të ofrohen lehtësime për periudha shumë të shkurtra, si p.sh., parkimi falas deri në 15 minuta për detyra të shkurtra, si p.sh., shkarkimi i mallrave ose ndalesa për të marrë pasagjerë.
6. Evente Speciale dhe Festat Lokale:
 - Gjatë eventeve të rëndësishme ose festave lokale të organizuara nga Bashkia Himarë, mund të ofrohen lehtësime në tarifat e parkimit për të gjithë përdoruesit ose për kategori specifike që marrin pjesë në aktivitet.

4.1 Metodat e Pagesës

1. Pagesa e Menjëhershme (Pay-as-you-go):
 - Kjo metodë përfshin pagesën për çdo orë parkimi përmes pajisjeve të dedikuara për pagesa në vend ose përmes aplikacioneve mobile.
 - Përdoruesit paguajnë për periudhën e saktë që parkojnë, me mundësinë për të shtuar kohën nëse qëndrimi zgjatet.
2. Abonime Mujore dhe Vjetore:
 - Bashkia Himarë mund të ofrojë abonime mujore ose vjetore për banorët ose përdoruesit që parkojnë rregullisht në të njëjtat zona por vetëm për orarin e ushtrimit të aktivitetit por ne te tera rastet jo me shume se orari i përcaktuar për tipologjitë e tjera.
 - Këto abonime lehtësojnë pagesën për periudha më të gjata dhe zakonisht ofrohen me tarifa më të ulëta sesa pagesa e përhershme për çdo orë.
3. Pagesa për Kategori të Veçanta:
 - Parkimi për automjetet elektrike, personat me aftësi të kufizuara dhe automjetet e shërbimit publik mund të ketë tarifa të reduktuara ose periudha falas.
4. Pagesa me Karta Kredi, Debiti dhe Parapaguese:
 - Përdoruesit mund të bëjnë pagesa përmes kartave të kreditit ose debitit në pajisjet elektronike të vendosura pranë hapësirave të parkimit.

Pervin
Gjukuria

Digitally signed by
Pervin Gjukuria
Date: 2025.03.19
20:00:16 +02'00'

Laert
Mezani

Digitally signed by
Laert Mezani
Date: 2025.03.19
19:13:37 +02'00'

Klodi
Ajazaj

Digitally signed by
Klodi Ajazaj
Date: 2025.03.19
09:57:04 +02'00'

- Mund të pranohen edhe kartat parapaguese të bashkisë, të cilat qytetarët mund t'i ngarkojnë me fonde paraprakisht dhe t'i përdorin për pagesa.
- 5. Pagesa përmes Aplikacioneve Mobile:
 - Bashkia mund të zhvillojë ose të bashkëpunojë me aplikacione mobile që lejojnë qytetarët të paguajnë parkimin përmes telefonave të tyre.
 - Aplikacionet mund të ofrojnë fleksibilitet të madh, duke përfshirë rimbushjen e kohës së parkimit nga larg dhe marrjen e njoftimeve për afatet e pagesës.
- 6. Pagesa prane operatoreve të parkimit, punonjës të drejtorisë së shërbimeve, të cilët depozitojnë pranë arkës së Bashkisë Himarë cdo përfundim turni.

4.2 Pajisjet për Pagesa Elektronike dhe Alternativa të Tjera

1. Automatet e Pagesës në Vend:
 - Vendosija e pajisjeve elektronike për pagesën e parkimit në vendndodhje të përshtatshme, afër hapësirave të parkimit, për t'i dhënë përdoruesve mundësinë për të bërë pagesën në mënyrë të lehtë dhe të shpejtë.
 - Këto automate mbështesin pagesën me para të gatshme, karta krediti/debiti dhe mundësinë për të lëshuar kuponë për periudhën e paguar.
2. Sistemi i Pagesave përmes Telefonit:
 - Përdoruesit mund të bëjnë pagesën përmes thirrjeve telefonike ose mesazheve SMS, ku përcaktojnë numrin e targës dhe periudhën e parkimit.
 - Ky sistem mund të jetë i lidhur me një shërbim të centralizuar që automatikisht konfirmon pagesën dhe e regjistron atë në sistemin e monitorimit të parkimit.
3. Aplikacioni i Bashkisë për Pagesa Mobile:
 - Një aplikacion i zhvilluar posaçërisht për Bashkinë Himarë, ku përdoruesit regjistrohen dhe përdorin llogaritë e tyre për të paguar parkimin.
 - Ky aplikacion mund të ofrojë funksione shtesë si rikujtues për përfundimin e periudhës së parkimit, mundësinë e zgjerimit të periudhës së paguar, dhe ruajtjen e historikut të pagesave.
4. Alternativa për Pagesa me Parapagim:
 - Bashkia mund të ofrojë kartela parapaguese që qytetarët mund t'i ngarkojnë paraprakisht dhe t'i përdorin për të paguar parkimin. Këto kartela janë të përshtatshme për individët që parkojnë rregullisht në të njëjtat zona.
 - Kartat parapaguese mund të rimbushen në pika të autorizuar, si në bashki ose në zyrat e shërbimit të autorizuar për këtë qëllim.

4.3 Menaxhimi i Pagesave dhe Monitorimi

1. Regjistri Qendror i Pagesave:
 - Të gjitha pagesat e kryera për parkimin regjistrohen në një sistem qendror të menaxhuar nga Bashkia Himarë, duke përfshirë informacionin për datën, kohën, vendndodhjen e parkimit dhe shumën e paguar.
 - Ky sistem ndihmon në monitorimin e pagesave dhe ndjekjen e gjobave për automjetet që nuk kanë paguar.
2. Verifikimi i Statusit të Pagesës përmes Pajisjeve Mobile

Pervin
Gjokuria

Digitally signed by
Pervin Gjokuria
Date: 2025.03.19
20:00:16 +02'00'

Laert
Mezani

Digitally signed by
Laert Mezani
Date: 2025.03.19
19:13:37 +02'00'

Klodi
Ajazaj

Digitally signed by
Klodi Ajazaj
Date: 2025.03.20
09:57:04 +02'00'

- Inspektorët e Policisë Bashkiake mund të pajisen me pajisje mobile që lejojnë kontrollin e pagesës për automjetet që parkohen në hapësirat publike. Këto pajisje tregojnë statusin e pagesës në kohë reale dhe identifikojnë shkeljet.
 - Kjo lehtëson monitorimin dhe ndihmon në vendosjen e gjobave për ata që nuk kanë kryer pagesën e kërkuar.
3. Raportet Ditore dhe Mujore të Pagesave:
- Bashkia përgatit raporte ditore dhe mujore për pagesat e parkimit, duke monitoruar të ardhurat dhe duke identifikuar trendet e përdorimit të hapësirave të parkimit.
 - Këto raporte ndihmojnë në analizimin e efikasitetit të sistemit të pagesës dhe përshtatjen e tarifave bazuar në kërkesën e parkimit.
4. Sistemi i Alarmeve për Shkeljet:
- Sistemi qendror i menaxhimit mund të vendosë alarme që sinjalizojnë automatikisht shkeljet, si parkimi pa pagesë apo kalimi i afatit të lejuar, duke dërguar njoftime inspektorëve për ndërhyrje të menjëhershme.
 - Inspektorët mund të veprojnë menjëherë për të vendosur gjobën dhe për të njoftuar pronarin e automjetit për shkeljen.
5. Auditimi Periodik i Pagesave dhe Monitorimit:
- Bashkia kryen auditime të rregullta të sistemit të pagesave për të siguruar përputhjen me rregullat dhe për të shmangur çdo parregullsi në menaxhimin e të ardhurave nga parkimi.
 - Auditimi ndihmon gjithashtu për të identifikuar çdo problem në sistemin elektronik të pagesave dhe për të përmirësuar shërbimet për qytetarët.

5.1 Rregullat e Përgjithshme për Përdoruesit e Parkimeve

1. Respektimi i Rregullave të Parkimit: Të gjithë përdoruesit e parkimeve publike janë të detyruar të respektojnë rregullat dhe udhëzimet e vendosura nga Bashkia Himarë për përdorimin e hapësirave të parkimit.
 2. Pagesa e Tarifës së Parkimit: Përdoruesit duhet të paguajnë tarifën e parkimit për kohëzgjatjen që do të përdorin hapësirën. Pagesa mund të kryhet përmes metodave të autorizuar, si makina elektronike, aplikacione mobile ose abonime të paracaktuara.
 3. Afati i Qëndrimit: Përdoruesit nuk mund të qëndrojnë në hapësirat e parkimit përtej kohës së paguar. Nëse qëndrimi tejkalon afatin, përdoruesi mund të gjobitet sipas dispozitave të rregullores.
 4. Rezidentët do mund të aplikojnë për kartën e rezidentit, sipas procedurës së miratuar nga Kryetari i Bashkisë pasi të miratojë rregulloren e posacme.
 5. Përdorimi i Tabelave dhe Shenjave të Drejtimit: Të gjitha tabelat dhe shenjat e drejtuara në hapësirat e parkimit duhet të respektohen. Këto përfshijnë shenjat për vendosjen e automjeteve në hapësira të caktuara dhe për shpejtësinë e lejuar brenda parkimit.
 6. Ruajtja e Rendit dhe Sigurisë: Përdoruesit janë të detyruar të ruajnë rendin dhe sigurinë në hapësirat e parkimit. Ndalohet kryerja e aktiviteteve të panevojshme, që mund të shkaktojnë pengesa ose të rrezikojnë përdoruesit e tjerë.
7. Përgjegjësia për Dëmet: Përdoruesit janë përgjegjës për dëmet e shkaktuara ndaj pronës publike në hapësirat e parkimit dhe mund të mbajnë përgjegjësi për çdo dëm që shkaktojnë me qëllim ose për neglizhencë.

Pervin
Gjokuria

Digitally signed by
Pervin Gjokuria
DN: cn=Pervin Gjokuria,
o=Bashkia e Himarës,
c=AL
Date: 2025.03.19
19:13:37 +02'00'

Laert
Mezani

Klodi
Ajazaj

Digitally signed by
Klodi Ajazaj
Date: 2025.03.20
09:57:04 +02'00'

5.2 Ndalesa dhe Kufizime Specifike për Përdorimin e Hapësirave të Parkimit

1. Ndalohet Parkimi i Paligjshëm: Parkimi i automjeteve në zona që nuk janë të autorizuar ose në zona të rezervuara për kategori specifike (si emergjenca, ngarkim/shkarkim) është i ndaluar dhe dënohet me gjobë.
2. Hapësira për Personat me Aftësi të Kufizuara: Vendparkimet e dedikuara për personat me aftësi të kufizuara mund të përdoren vetëm nga automjetet që kanë shenjën përkatëse të identifikimit. Parkimi i paautorizuar në këto hapësira dënohet me gjobë.
3. Kufizimet për Parkimet e Gjatë Qëndrimit: Në disa zona të caktuara, parkimi mund të jetë i kufizuar për një periudhë të caktuar kohore për të shmangur mbingarkesën. Përdoruesit duhet të respektojnë kohëzgjatjen maksimale të qëndrimit të lejuar.
4. Automjete të Rënda dhe Të Gjatë: Automjetet e rënda, ato të transportit të mallrave ose automjetet e mëdha që nuk i përkasin shërbimeve të qytetit, nuk mund të parkojnë në zona të rezervuara për automjete të vogla. Për këto automjete do të ketë zona të dedikuara.
5. Ndalohet Shërbimi i Automjeteve në Hapësira Publike: Çdo lloj shërbimi i automjeteve (si larja ose riparimi) në hapësirat publike të parkimit është i ndaluar, përveç rasteve emergjente ose kur janë të autorizuar nga bashkia.
6. Moslejimi i Parkimit për Qëllime Reklamimi: Automjetet e pajisura me reklama ose mesazhe të mëdha që kanë si qëllim reklamimin në hapësirat e parkimit ndalohen të parkojnë për periudha të gjata.

5.3 Kushtet e Përdorimit të Hapësirave për Automjetet Elektrike dhe Ato për Ngarkim/Shkarkim

1. Automjetet Elektrike:
 - Hapësira të Dedikuara: Bashkia do të mund të ofrojë hapësira të dedikuara për parkimin dhe karikimin e automjeteve elektrike. Këto hapësira do të jenë të pajisura me stacione karikimi që mund të përdoren nga qytetarët.
 - Karikimi i Automjeteve Elektrike: Vetëm automjetet që kanë nevojë për karikim mund të përdorin këto hapësira për një kohë të caktuar që të mundësojë karikimin. Pas përfundimit të karikimit, përdoruesit duhet të lirojnë hapësirën.
 - Përdorimi i Stacioneve të Karikimit: Bashkia mund të aplikojë tarifa shtesë për përdorimin e stacioneve të karikimit, të cilat do të rregullohen në bazë të energjisë së konsumuar dhe kohës së përdorimit.
2. Hapësirat për Ngarkim dhe Shkarkim:
 - Kufizimet e Kohës: Hapësirat për ngarkim dhe shkarkim të mallrave janë të rezervuara vetëm për periudha të caktuara të ditës dhe për një kohë të kufizuar për të mundësuar qarkullimin e automjeteve të tjera.
 - Përdorimi për Shërbime Publike dhe Komerciale: Këto hapësira mund të përdoren vetëm nga automjetet e pajisura me autorizim të Bashkisë Himarë ose nga kompani që kryejnë shërbime të licencuara për ngarkim dhe shkarkim.
 - Ndalohet Përdorimi për Qëndrim të Gjatë: Automjetet nuk mund të qëndrojnë në këto hapësira për qëllime parkimi të gjatë apo qëndrimi të panevojshëm. Çdo qëndrim jashtë afatit të lejuar dënohet sipas rregullores.

Pervin
Gjukuria

Digitally signed by
Pervin Gjukuria
Date: 2025.03.19
20:00:16 +02'00'

Laert
Mezani

Digitally signed by
Laert Mezani
Date: 2025.03.19
19:13:37 +02'00'

Klodi
Ajazaj

Digitally signed by
Klodi Ajazaj
Date: 2025.03.20
09:57:04 +02'00'

6.1 Metodat e Monitorimit të Parkimeve

1. Monitorimi Elektronik: Bashkia mund të instalojë sisteme elektronike për monitorimin e hapësirave të parkimit, përfshirë sensorët për vendparkime dhe kamera të mbikëqyrjes që regjistrojnë hyrjen dhe daljen e automjeteve në kohë reale. Ky sistem ndihmon për të identifikuar shkeljet dhe për të menaxhuar më mirë hapësirat e parkimit.
2. Sistemi i Kontrollit të Pagesës: Për parkimet me pagesë, mund të përdoren sisteme elektronike për verifikimin e pagesës, duke përfshirë terminale pagese, aplikacione mobile ose pajisje që regjistrojnë nëse një automjet ka paguar ose jo për parkimin. Ky sistem ndihmon për të siguruar pagesën e tarifave të parkimit nga të gjithë përdoruesit.
3. Patrullimi i Rregullt nga Policia Bashkiake: Autoritetet e Policisë Bashkiake kryejnë inspektime të rregullta për të monitoruar përdorimin e hapësirave të parkimit. Patrullimet bëhen për të kontrolluar zbatimin e rregullave, si respektimi i kohës së parkimit, pagesa e tarifave dhe përdorimi i hapësirave të dedikuara për kategori specifike, si personat me aftësi të kufizuara ose automjetet elektrike.
4. Teknologji për Verifikim dhe Kontroll: Mund të përdoren pajisje të dorës për verifikimin e targave të automjeteve dhe kontrollin e pagesave. Inspektorët mund të përdorin këto pajisje për të skanuar targat dhe për të kontrolluar statusin e pagesës për parkim në kohë reale.
5. Raportimi nga Qytetarët: Qytetarët mund të njoftojnë shkeljet e rregullave të parkimit përmes një platforme të dedikuar, si një aplikacion ose një linjë telefonike. Këto raportime ndihmojnë Policinë Bashkiake të ndërmarrë veprime të menjëhershme për shkeljet e raportuara.

6.2 Kontrolli nga Autoritetet Bashkiake dhe Sanksionet për Shkelje

1. Roli i Policisë Bashkiake: Policia Bashkiake është përgjegjëse për kontrollin dhe zbatimin e rregullores së parkimeve publike. Ata kanë autoritetin për të inspektuar hapësirat e parkimit, për të lëshuar paralajmërime dhe për të vendosur gjoka për shkeljet e rregullave të parkimit.
2. Sanksionet për Shkelje të Rregullave: Shkeljet e rregullores së parkimit janë të dënueshme me gjobë. Disa nga shkeljet që sanksionohen përfshijnë:
 - o Parkimi pa pagesë në zonat e caktuara për parkim me pagesë.
 - o Parkimi në hapësira të rezervuara për persona me aftësi të kufizuara pa autorizimin e duhur.
 - o Parkimi i automjeteve të rënda në hapësira të destinuara për automjete të lehta.
 - o Qëndrimi përtej afatit të paguar të parkimit.
3. Gjoka të Diferencuara: Sanksionet mund të jenë të diferencuara bazuar në llojin e shkeljes. Për shkeljet më të rënda, gjokat mund të jenë më të larta ose mund të ketë masa të tjera, si bllokimi i automjetit ose tërheqja e tij nga hapësira e parkimit.
4. Vendosja e Paralajmërimeve: Për shkeljet e para ose për raste të lehta, autoritetet mund të lëshojnë paralajmërime me shkrim, duke i informuar përdoruesit për shkeljen dhe duke kërkuar që të shmangin përsëritjen e saj. Kjo ndihmon për ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe për përmirësimin e disiplinës në parkim.

Pervin
Gjokuria

Digitally signed by
Pervin Gjokuria
Date: 2025.03.19
20:00:16 +02'00'

Laert
Mezani

Digitally signed by
Laert Mezani
Date: 2025.03.19
19:13:37 +02'00'

Klodi
Ajazaj

Digitally signed by
Klodi Ajazaj
Date: 2025.03.20
09:57:04 +02'00'

6.3 Procedura e Vendosjes dhe Zbatimit të Gjobave

1. Regjistrimi i Shkeljes: Kur një shkelje konfirmohet nga Policia Bashkiake ose nga sistemi i monitorimit elektronik, detajet e shkeljes regjistrohen në sistemin e menaxhimit të parkimeve. Informacioni përfshin datën, orën, vendndodhjen dhe llojin e shkeljes.
2. Njoftimi i Përdoruesit për Gjobën: Pasi regjistrohet shkelja, përdoruesi njoftohet për gjobën në vend, përmes një fletë gjobe të vendosur në automjet ose përmes një njoftimi të dërguar elektronikisht, nëse është e mundur. Njoftimi përmban informacion mbi llojin e shkeljes, shumën e gjobës dhe afatin për pagesën.
3. Afati dhe Procedura e Pagesës së Gjobës: Përdoruesit duhet të paguajnë gjobën brenda një afati të caktuar nga data e njoftimit. Gjobat mund të paguhet përmes platformave të miratuara nga bashkia, si sistemet elektronike ose bankat partnere.
4. Reduktimi i Gjobës për Pagesë të Shpejtë: Për të inkurajuar pagesën e menjëhershme, mund të aplikohet një zbritje për ata përdorues që paguajnë gjobën brenda një afati të shkurtër, si p.sh., brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit.
5. Ankimi për Gjobën: Përdoruesit kanë të drejtën të ankimojnë gjobën brenda një periudhe prej 10 ditësh. Ankesat mund të dorëzohen në njësinë përgjegjëse të Bashkisë Himarë, e cila shqyrton rastin dhe vendos për vlefshmërinë e gjobës.
6. Masat për MosPagesën e Gjobave: Nëse një gjobë nuk paguhet brenda afatit të caktuar dhe nuk ankimohet, bashkia mund të marrë masa të tjera, si:
 - o Rritje e Gjobës: Shtohet një tarifë e vonësës.
 - o Bllokimi i Automjetit: Automjeti mund të bllokohet ose të tërhiqet nga hapësira e parkimit deri në shlyerjen e gjobës.
 - o Njoftimi i Autoriteteve të Tatimeve: Në rastet kur gjobat nuk paguhet, autoritetet e tatimeve mund të ndërhyjnë për mbledhjen e detyrimeve financiare.
7. Regjistrimi në Sistemin e Gjobave: Të gjitha gjobat dhe statuset e tyre regjistrohen në një sistem qendror që mbikëqyret nga Bashkia Himarë. Ky regjistër ndihmon për të ndjekur gjobat e papaguara dhe për të marrë masa për zbatimin e tyre në rast mosrespektimi.

7.1 Mekanizmi i Ankesave për Qytetarët

1. Qendra e Ankesave: Bashkia Himarë do të krijojë një komision të dedikuar për ankesat e qytetarëve për gjobat e parkimit, e cila mund të jetë fizike (p.sh., në një zyrë të bashkisë) ose virtuale (p.sh., në një platformë online të bashkisë). Kjo qendër do të pranojë dhe administrojë ankesat në një mënyrë të organizuar dhe transparente.
2. Formulari i Ankesës: Çdo qytetar që dëshiron të ankimojë një gjobë duhet të plotësojë një formular ankese, duke përfshirë informacionet si:
 - o Emri dhe mbiemri i aplikuesit
 - o Detajet e automjetit dhe numri i targës
 - o Kopje e njoftimit për gjobën
 - o Arsytet e ankesës dhe provat që mbështesin pretendimet e qytetarit (p.sh., fatura e pagesës ose autorizimet e veçanta).
 - o mandatin e pagesës ose vertetimin e pagesës
3. **Metodat e Dorëzimit të Ankesës:** Ankesa mund të dorëzohet:
 - o Në mënyrë fizike në qendrën e ankesave të bashkisë
 - o Përmes postës elektronike në adresën e dedikuar të bashkisë për ankesat
 - o Përmes platformave elektronike të bashkisë, nëse janë të disponueshme.
4. **Kostot e Ankesës:** Paraqitja e një ankese për shqyrtim është pa pagesë për qytetarët.

Pervin Gjokuria

Digitally signed by
Pervin Gjokuria
Date: 2025.03.19
20:00:16 +02'00'

Laert Mezani

Digitally signed by
Laert Mezani
Date: 2025.03.19
19:13:37 +02'00'

Klodi Ajazaj

Digitally signed by
Klodi Ajazaj
Date: 2025.03.20
09:57:04 +02'00'

7.2 Afatet dhe Procedurat për Shqyrtimin e Ankesave

1. Afati për Paraqitjen e Ankesës: Qytetarët duhet të paraqesin ankesën brenda një periudhe të caktuar nga data e vendosjes së gjobës (brenda 10 ditëve pune). Nëse ankesa nuk paraqitet brenda këtij afati, qytetari humb të drejtën për të apeluar gjobën.
2. Afati për Shqyrtimin e Ankesës: Bashkia do të shqyrtojë dhe do t'i përgjigjet ankesës brenda një periudhe të arsyeshme kohore (brenda 10 ditëve pune nga data e dorëzimit të ankesës). Në rastet kur kërkohet verifikim shtesë, bashkia do të njoftojë qytetarin për shtyrjen e afatit.
3. Procesi i Shqyrtimit:
 - o Rishikimi i Dokumentacionit: Një komision i dedikuar shqyrton dokumentacionin dhe provat e dorëzuara nga qytetari, si dhe informacionin që justifikon vendosjen e gjobës.
 - o Verifikimi i Provave: Komisioni mund të kërkojë informacione shtesë ose të verifikojë me inspektorët e Policisë Bashkiake për detaje të mëtejshme të ngjarjes.
 - o Vendimi për Anulimin ose Konfirmimin e Gjobës: Bazuar në provat e ofruara dhe shqyrtimin e kujdesshëm, komisioni merr një vendim për pranimin ose refuzimin e ankesës.
4. Njoftimi i Qytetarit për Vendimin: Qytetari njoftohet me shkrim për vendimin e marrë nga bashkia. Në rast të një vendimi pozitiv, gjoba do të anulohet ose do të zbutet, ndërsa në rastin e një vendimi negativ, qytetarit do t'i kërkohet të paguajë gjobën brenda një afati të ri të caktuar.

7.3 Dispozitat për Zbutjen ose Anulimin e Gjobave

1. Kushtet për Anulimin e Gjobës: Gjobat mund të anulohen në rastet e mëposhtme:
 - o Provë për pagesë: Qytetari ofron prova të qarta që tregojnë se pagesa është kryer në mënyrë korrekte dhe në kohë.
 - o Gabim Administrativ: Në rastet kur është vendosur një gjobë për shkak të një gabimi administrativ nga ana e bashkisë ose e Policisë Bashkiake, gjoba mund të anulohet plotësisht.
 - o Rrethana të Jashtëzakonshme: Në rastet e emergjencës, dëmtimeve të rënda mjekësore ose rrethanave të tjera të jashtëzakonshme që justifikojnë parkimin në vendet e ndaluara, gjoba mund të anulohet.
2. Procedurat për Anulimin ose Zbutjen:
 - o Vendimi për anulimin ose zbutjen e gjobës do të merret nga komisioni pas shqyrtimit të ankesës dhe provave të paraqitura.
 - o Në raste të veçanta, qytetarit mund t'i kërkohet të ndjekë trajnime ose informime për rregullat e parkimit si pjesë e një programi ndërgjegjësimi, sidomos nëse është një shkelës i përsëritur.
3. Ankimi për Vendimin e Komisionit: Nëse qytetari nuk është i kënaqur me vendimin përfundimtar të komisionit, ai ka të drejtë të ndjekë rrugët ligjore për të apeluar vendimin, në përputhje me dispozitat e ligjit për kundravajtjet administrative.

Pervin
Gjilkuria

Digitally signed by
Pervin Gjilkuria
Date: 2025.03.19
19:04:49 +02'00'

8. Dispozita Kalimtare dhe Përfundimtare

Kjo rregullore do të hyjë në fuqi nga data e përcaktuar pas miratimit nga Kryetari i Bashkisë. Çdo ndryshim apo përditësim i rregullores do të publikohet përparakisht për transparencë.

Laert
Mezani

Digitally signed by
Laert Mezani
Date: 2025.03.19
19:13:37 +02'00'

Klod
Ajazaj

Digitally signed by
Klod Ajazaj
Date: 2025.03.20
09:57:04 +02'00'

Rregullore e parkimeve publike me pagese Bashkia Himare

SHQIPËRISË

REPUBLIKA E

BASHKIA HIMARË

KËSHILLIT BASHKIAK

KOMISIONI I PËRHERSHËM I ZHVILLIMIT URBAN, INFRASTRUKTURES
SHËRBIMEVE PUBLIKE

Raporti i vendimmarrjes së komisionit të përherëshëm

(Adresa, Spite - Himare nr. Tel _____, e-mail www.himara.gov.al).

Komisioni i Përherëshëm për "Zhvillimin urban, infrastrukturës, shërbimeve
publike".
RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. 2534/ Prot

Nr. 2534/ Datë: 20.3.2024

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekvendimit nr. 2534/ datë 20.3.2024, relacionit e dokumentat
shoqërues në lidhje me propozimin për "miratim rregullore të hapësirave
publike me Bashkië Himarë".

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore) Bazuar në ligjin e vetëqeverisjes vendore
139/2015 "indishtuar, ligji Nr. 44/2025" Kodi i procedurave administrative

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit) Nuk ka pagese me
pari rregullore për parkimet publike, me
impakt për komunitet.

Situata financiare : (Shtesa / pakësime në buxhet) Shtesa me buxhet.

Drejtorja / Sektori përgjegjës Sektori përgjegjës drejtorisë finances
dhe drejtorisë juridike.

Monitorimi dhe raportimi : (kush monitoron, raporton dhe sa shpesh) Raporton drejtori
finances, juridik.

Impakti social / grupet që preken: Bashkia, Banoret.

A është objekt i konsultimit publik: Jo.

A. C. As. H. Azari

Komisioni i Përhershëm për "Zhvillimin urban" ^{infrastruktura}, i mbledhur me datën 28.03.2024, shqyrtoi projekt vendimit nr. 2534/ datë 28.03.2024, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Kryeqendra" paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese, komisioni

me shumicë votash,

VENDOSI;

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:
- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
 - b) miratimin e projektaktit
 - c) refuzimin e miratimit të projektaktit
 - d) miratimin e projekt-aktit me ndryshimet si vijon:
 - ✓ Pika 1 (një) e projekt vendimit të ndryshoje në "-----"
 - ✓ Pika 4 (katër) e projekt vendimit të ndryshoje në "-----"
 - ✓ Tabela nr. 6 (gjashtë) e projekt vendimit të ndryshoje në "-----"
 - ✓ Paragrafi 15 (pesëmbëdhjetë) i projekt vendimit të ndryshoje në "-----"

Bashkëlidhur argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së Komisionit

Jimoleo Gerdhugj Kryetar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

(emri, mbiemri, firma)

Aprorita Shimozani
Antonin Shushaj
Aleks Kazar

Datë _____ 2024

Komisioni për rregulloren e parkimeve publike me pagese Bashkia Himare

Proçesverbali i mbledhjes së komisionit të përhershëm të këshillit

Data 28.3.2025.

Ora e hapjes së mbledhjes 14:00

- Marrin pjesë :
1. Timoteo Gerdhugi këshilltar- kryetar i komisionit
 2. Qirjako Meroni këshilltar – nënkryetar komisioni - meron
 3. Arbanta Shingari sekretar i komisionit
 4. Anëtar Artionit Shirokaj
 5. Anëtar Aleks Harazi
 6. Anëtar _____
 7. Anëtar _____

Marrin pjesë gjithashtu : Këshilltarë / pjestarë të sekretariatit

1. Silva Burbo
2. Miltiadi Difti
3. Elisabeta Lamej
4. Thelena Kokaredu

Nga ekzekutivi marrin pjesë :

Kryesuesi i mbledhjes është Z/Zj Timoteo Gerdhugi

Kryetari i Këshillit/ Kryesuesi i mbledhjes deklaroi kuorumin prej 4 Këshilltarësh.

Deklarimi i konfliktit të interesit:

Bashkia Himare dhe komunitet janë me interes të marrëdhënies me rregulloren.

Pika 1 e rendit të ditës.

Projektvendim " Për miratimin e rregullores për parkimet publike me pagese. " propozuar nga > kryetari

Drejtuksi i komisionit prezanton projektvendimin

Pyetje (nga këshilltarët)

Z. Lard Meroni
Jane përcaktuar zonat e parkimit?
Z. Aleks Harazi

Përgjigje / sqarime nga ekzekutivi

Edo informacioni ua kemi perqell
te materialit, edhe une po ju sqarim
po.
Aleks Harazi

Diskutime :

Këshilltari _____deklaroi / propozoi_____

Këshilltari _____deklaroi / propozoi_____

Këshilltari _____deklaroi / propozoi_____

Hidhen në votë propozimet për amendim të projektvendimit :

Propozim 1 : Vota PRO _____ Kundra _____Abstenim _____Miratohet / Nuk miratohet

Propozim 2 : Vota PRO _____ Kundra _____Abstenim _____Miratohet / Nuk miratohet

Propozim 3 : Vota PRO 4 Kundra - Abstenim - Miratohet / Nuk miratohet

Pika 2 e rendit të ditës.

Projektvendim “ _____ ” propozuar nga _____

Drejtuesi i komisionit prezanton projekt-vendimin

Pyetje (nga këshilltarët) _____

Përgjigje / sqarime nga ekzekutivi _____

Diskutime :

Këshilltari _____ deklaroi / propozoi _____

Këshilltari _____ deklaroi / propozoi _____

Këshilltari _____ deklaroi / propozoi _____

Hidhen në votë propozimet për amendim të projekt-vendimit :

Propozim 1 : Vota PRO _____ Kundra _____ Abstenim _____ Miratohet / Nuk miratohet

Propozim 2 : Vota PRO _____ Kundra _____ Abstenim _____ Miratohet / Nuk miratohet

Propozim 3 : Vota PRO _____ Kundra _____ Abstenim _____ Miratohet / Nuk miratohet

Mbyllet diskutimi

Përgatitet Raporti i mbledhjes së Komisionit për çdo projekt-vendim që do t'i paraqitet këshillit ne seancë.

Raporti u përgatit nga Kryetari / zëvendëskryetari i Komisionit/ sekretari i Komisionit

Lexohet Raporti (1, 2) nga Kryetari / zëvendëskryetari (për çdo projekt-vendim)

Votohet Raporti (1, 2) : Votimi u bë i hapur/ fshehtë – (për çdo projekt-vendim)

U votua raporti Projektvendim nr. _____, PRO _____ KUNDER _____ ABSTENIM _- Miratohet / Nuk miratohet

U votua raporti Projektvendim nr. _____, PRO _____ KUNDER _____ ABSTENIM _- Miratohet / Nuk miratohet

Mbyllet mbledhja e Komisionit

Komisioni vendosi që rregullojë për partimet
publike me Bashkësinë Himarë të Kalaje Keshillat
për shqyrtim të metejshëm.

Ora e mbylljes së mbledhjes 18:00

Nënshkruhet procesverbali i mbledhjes së komisionit

Kryetari i Komisionit

Jimotao Gerdhugji

Sekretari i Komisionit

A. D. H.

Artzim / Shkurty
Aleks / H. Z. H. ASD

Afrovita. Dhimajoni Arqun